AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

# VLERËSIM
# Popullsia e Kosovës 2015



**Prishtinë**
**Qershor 2016**

Republika e Kosoves
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada -Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

# VLERËSIM
# Popullsia e Kosovës 2015

P r i s h t i n ë
Qershor 2016

## Lista e shkurtesave dhe simboleve

| | | |
|---|---|---|
| **ASK** | - | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| **RAE** | - | Rom, Ashkali dhe Egjiptian |
| **MPB** | - | Ministria e Punëve të Brendshme |
| **IOM** | - | Organizata Ndërkombëtare për Migrim |
| **UNHCR** | - | Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët |
| **EUROSTAT** | - | Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian |
| **EFTA** | - | Asociacioni i Tregtisë së Lirë të Evropës |
| **0** | - | E dhëna është më e vogël se 0,5 e njësisë së dhënë të matjes |
| **:** | - | Mungojnë të dhënat |
| **-** | - | Nuk ka dukuri |

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Qershor, 2016
© : Agjencia e Statistikave të Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet http://ask.rks-gov.net/

# P a r a t h ë n i e

Vlerësimi i popullsisë së Kosovës ka për qëllim që ta sigurojë një vlerësim të saktë statistikor mbi popullsinë, i cili është i nevojshëm, praktik dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi.

Kjo për faktin se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune a vendbanimi dhe vlerësimi i popullsisë është me se i nevojshëm për nxjerrjen e indikatorëve të rëndësishëm socio-ekonomik. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) do të vazhdojë të bëjë vlerësimin, çdo vit, të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune. Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash. Sidomos lidhja dhe rëndësia e veçantë e tyre me çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale.

Statistikat mbi popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrësve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave. Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimit dhe çështjeve të tjera socio–ekonomike. Prandaj, për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave, këto janë të dhënat e fundit zyrtare, të vlerësuara për numrin e popullsisë së Kosovës në nivel të komunave për vitin 2015.

Ky raport është përgatitur nga stafi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

*Në përgatitjen e publikimit kontribuan:*
Dr. sc. Bashkim Bellaqa, Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale
Mr. Avni Kastrati, Shef i Divizionit të Statistikave të Popullsisë- përpunimin dhe analizimin e të dhënave
Sanije Uka, Zyrtare e Lartë e Statistikave të Popullsisë
Arijeta Sojeva, Zyrtare e lartë e Statistikave Vitale
Elvira Tahiri, Zyrtare e Statistikave të Popullsisë
Vjollca Berisha, Zyrtare e Statistikave Vitale
Ahmet Cakolli, Zyrtar për dizajn.

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

# Përmbajtja

Faqe

P a r a t h ë n i e ........................................................................................................ 4
H Y R J E ........................................................................................................ 6
Për shfrytëzuesit e të dhënave ........................................................................................................ 6
Baza mbi vlerësimin e popullsisë ........................................................................................................ 6
Vështrimi metodologjik........................................................................................................ 6
Burimet e të dhënave ........................................................................................................ 7
Popullsia bazë........................................................................................................ 7
Migrimi ........................................................................................................ 8
Emigrimi ndërkombëtar: ........................................................................................................ 8
Migrimi kombëtar: ........................................................................................................ 8
Rritja e përgjithshme ........................................................................................................ 8
Tab.1.Popullsia e Kosovës në vitin 2014 dhe shtimi natyror në vitin 2015 në nivel të komunave..9
Tab. 2. Gjithsej, popullsia e Kosovës në vitin 2014 dhe migrimi për vitin 2015 .......................... 10
Tab. 3 Gjithsej, popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2015 .................................................. 11

# H Y R J E

## Për shfrytëzuesit e të dhënave

Ky raport përfshin ndryshimet e numrit të popullsisë (shtimin natyror dhe migrimin) gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2015 në territorin e Kosovës.

## Baza mbi vlerësimin e popullsisë

Në përgatitjen e këtij Vlerësimi, ASK-ja ka aplikuar metodat e praktikuara mbi vlerësimin e popullsisë, që aplikohen nga institucionet statistikore, duke shfrytëzuar burimet e ndryshme. Baza e të dhënave për ta vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2015, është marrë numri i vlerësuar i popullsisë rezidente në Kosovë, në fund të vitit 2014.

## Vështrimi metodologjik

Për ta vlerësuar numrin e popullsisë rezidente në nivel kombëtar/komunal, popullsia është e ndikuar nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi. (NMM).

Vlerësimi i popullsisë: popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi i jashtëm/brendshëm.

Të dhënat e vlerësuara përfundimtare mbi numrin e popullsisë në nivel të komunave janë llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

Pn + (N-M)+(I–E)

Pn -Numri i banorëve të përllogaritur për vitin e dhënë (2014)

N -Numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti), 01 janar-31 dhjetor 2015

M -Numri i vdekjeve (Mortaliteti), 01 janar-31 dhjetor 2015

I - Imigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2015

E –Emigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2015

## Burimet e të dhënave

Janë shfrytëzuar burime të ndryshme statistikore si: Vlerësimi i vitit 2014, baza e të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2011, bazat e shënimeve nga Statistikat e Lindjeve dhe Vdekjeve (ASK), të dhënat administrative (bazat e ndryshme të ASK-së) të dhënat nga komunat e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM-Zyra e Kosovës), Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR-Zyra e Kosovës) baza e shënimeve nga EUROSTATI, zyrat statistikore dhe ato të migrimit nga disa shtete, ku ishte më i shprehur emigrimi kosovar.

Po ashtu, janë shfrytëzuar të dhënat e tjera administrative nga institucionet vendore, anketat, raportet dhe hulumtimet e tjera.

Këto të dhëna janë analizuar sipas metodave statistikore, duke shërbyer si instrumente dhe shënime të rëndësishme statistikore për vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe në nivel të komunave.

## Popullsia bazë

Sipas “Vlerësimit të popullsisë për vitin 2014” numri i popullsisë rezidente në Kosovë ishte 1,804,944 banorë rezident.

**Shtimi natyror:** popullsia e Kosovës gjatë vitit 2014 është rritur për 22,232 banorë.

**Lindjet:** sipas të dhënave nga baza e shënimeve të ASK-së numri i lindjeve (të regjistruara) për vitin 2015 ishte gjithsej 31,433 lindje të gjalla, prej tyre me vendbanim te përhershëm te nënës në Kosovë (rezident) ishin gjithsej, 31,116 lindje. Ky numër i lindjeve do të merret si bazë në vlerësimin e popullsisë rezidente në Kosovë.

**Vdekjet:** bazuar në të dhënat nga baza e shënimeve të ASK, numri i vdekjeve (të regjistruara) për vitin 2015, ishte gjithsej 8,958 vdekje prej tyre me vendbanimin rezident në Kosovë ishin 8,884 raste të vdekjeve. Ky numër i vdekjeve do të merret si bazë në vlerësimin e popullsisë rezidente në Kosovë.

## Migrimi

**Imigrimi ndërkombëtar:** sipas të dhënave nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), komuna, UNHCR, IOM dhe të dhënat nga disa komuna, numri i të kthyerve (imigrantëve) në Kosovë, gjatë vitit 2015 ishte gjithsej 18,862 banorë. Në këtë numër janë përfshirë te kthyerit/riatdhesuarit, numri i azilkërkuesve të Kosovës, si dhe leje qëndrimet më shumë se një (1) vit nga qytetaret e vendeve tjera.

**Emigrimi ndërkombëtar:** numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2015 është vlerësuar të jetë gjithsej 74,434 banorë. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët legalë dhe ata ilegalë. Pjesa kryesore e emigrantëve për vitin 2015, ishin emigrantët e quajtur *ilegal* që kërkuan azil (*aplikuesit për herë të parë*) në vendet e BE-së përfshirë vendet e Asociacionit të Tregtisë së Lirë të Evropës (EFTA)-ës me 67,530 emigrant ndërsa, një numër simbolik (disa qindra) kosovarë vlerësohen se emigruan në mënyrë ilegale, por që nuk ishin lajmëruar tek institucionet pritëse të vendeve përkatëse. Një numër i konsiderueshëm i kosovarëve emigroi në formë *legale* për shkak të: bashkimit familjar, martesave, gjetja e një vendi pune, shpërngulje të përhershme (kryesisht në shtete fqinje), studime afatgjata me punësim etj. Përveç vendeve të BE-së dhe EFTA-së një numër i kosovare kishte emigruar edhe në vende të tjera kryesisht në SHBA dhe Kanada. Numri emigranteve kosovar ***përveç*** atyre që kishin kërkuar azil është përllogaritur të jetë 6,904 emigrant.

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2015 ishte -55,572 banorë.

**Migrimi kombëtar:** gjatë vitit 2015, vlerësohet se një numër i konsiderueshëm i popullsisë rezidente në Kosovë ka ndërruar vendbanimin (komunën) për arsye të ndryshme kryesisht për shkaqe të shpërnguljes, nga vendbanimet rurale në ato urbane dhe sub-urbane, si dhe për shkak të martesave. Sipas vlerësimit numri i personave që e kanë ndërruar vendbanimin nga komuna e mëparshme (nga një komunë në komunë tjetër brenda Kosovës) është gjithsej 8, 972 banorë

## Rritja e përgjithshme

Bazuar në këto të dhëna, përkundër shtimit natyror pozitiv te popullsisë prej 22,232 banorëve për shkak të emigrimit ndërkombëtar, popullsia rezidente e Kosovës për periudhën 01 janar - 31 dhjetor 2015 është zvogëluar për -33,340 banorë. Popullsia në Kosovë për vitin 2015 vlerësohet të jetë 1,771,604, banorë rezident.

**Tab. 1. Popullsia e Kosovës në vitin 2014 dhe shtimi natyror në vitin 2015 në nivel të komunave**

| Nr. | Komuna | Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2014) | Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë | | | Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror (01.01-31.12 2015) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nataliteti (2015) | Mortaliteti (2015) | Shtimi natyror (01.01-31.12/2015) | |
| 1 | Deçan | 40,847 | 707 | 138 | 569 | 41,416 |
| 2 | Gjakovë | 95,576 | 1,647 | 534 | 1,113 | 96,689 |
| 3 | Gllogoc | 60,111 | 1,080 | 245 | 835 | 60,946 |
| 4 | Gjilan | 87,385 | 1,456 | 534 | 922 | 88,307 |
| 5 | Dragash | 34,241 | 519 | 281 | 238 | 34,479 |
| 6 | Istog | 39,963 | 767 | 220 | 547 | 40,510 |
| 7 | Kaçanik | 33,784 | 556 | 171 | 385 | 34,169 |
| 8 | Klinë | 39,527 | 916 | 184 | 732 | 40,259 |
| 9 | Fushë Kosovë | 37,735 | 721 | 191 | 530 | 38,265 |
| 10 | Kamenicë | 33,599 | 418 | 220 | 198 | 33,797 |
| 11 | Mitrovicë e J. | 71,636 | 1,349 | 388 | 961 | 72,597 |
| 12 | Mitrovica e V. | 12,173 | 26 | 15 | 11 | 12,184 |
| 13 | Leposaviq | 13,515 | 26 | 10 | 16 | 13,531 |
| 14 | Lipjan | 58,373 | 990 | 246 | 744 | 59,117 |
| 15 | Novobërdë | 6,953 | 54 | 34 | 20 | 6,973 |
| 16 | Obiliq | 21,056 | 333 | 104 | 229 | 21,285 |
| 17 | Rahovec | 58,214 | 1,042 | 280 | 762 | 58,976 |
| 18 | Pejë | 97,776 | 1,893 | 515 | 1,378 | 99,154 |
| 19 | Podujevë | 86,836 | 1,452 | 378 | 1,074 | 87,910 |
| 20 | Prishtinë | 207,062 | 3,418 | 926 | 2,492 | 209,554 |
| 21 | Prizren | 184,586 | 3,264 | 990 | 2,274 | 186,860 |
| 22 | Skenderaj | 51,553 | 1,005 | 229 | 776 | 52,329 |
| 23 | Shtime | 27,818 | 485 | 122 | 363 | 28,181 |
| 24 | Shtërpcë | 6,906 | 130 | 120 | 10 | 6,916 |
| 25 | Suharekë | 60,869 | 1,259 | 322 | 937 | 61,806 |
| 26 | Ferizaj | 107,985 | 1,926 | 496 | 1,430 | 109,415 |
| 27 | Viti | 47,434 | 799 | 226 | 573 | 48,007 |
| 28 | Vushtrri | 68,793 | 1,155 | 352 | 803 | 69,596 |
| 29 | Zubin Potok | 6,537 | 25 | 7 | 18 | 6,555 |
| 30 | Zveçan | 7,341 | 22 | 4 | 18 | 7,359 |
| 31 | Malishevë | 56,889 | 1,236 | 174 | 1,062 | 57,951 |
| 32 | Junik | 6,319 | 84 | 25 | 59 | 6,378 |
| 33 | Mamushë | 5,791 | 73 | 33 | 40 | 5,831 |
| 34 | Hani i Elezit | 9,759 | 175 | 57 | 118 | 9,877 |
| 35 | Graçanicë | 11,720 | 32 | 7 | 25 | 11,745 |
| 36 | Ranillug | 3,835 | 44 | 48 | -4 | 3,831 |
| 37 | Partesh | 1,738 | 18 | 37 | -19 | 1,719 |
| 38 | Kllokot | 2,709 | 14 | 21 | -7 | 2,702 |
| **Gjithsej** | | **1,804,944** | **31,116** | **8,884** | **22,232** | **1,827,176** |

**Tab. 2. Gjithsej, popullsia e Kosovës në vitin 2014 dhe migrimi për vitin 2015**

| Nr. | Komuna | Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2014) | Migrimi ndërkombëtar (2015) | | | Migrimi kombëtar (2015) | | | Bilanci i përgjithshëm i migrimit në nivel komune 2015 | Gjithsej popullsia dhe migrimi (01.01-31.12 2015) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Imigrimi | Emigrimi | Bilanci i migrimit ndërkombëtar 2015 | Imigrimi | Emigrimi | Bilanci i migrimit kombëtar | | |
| 1 | Deçan | 40,847 | 247 | 453 | -206 | 121 | 158 | -37 | -243 | 40,604 |
| 2 | Gjakovë | 95,576 | 994 | 3,046 | -2052 | 259 | 353 | -94 | -2146 | 93,430 |
| 3 | Gllogoc | 60,111 | 622 | 1,241 | -619 | 231 | 383 | -152 | -771 | 59,340 |
| 4 | Gjilan | 87,385 | 1,142 | 8,871 | -7729 | 349 | 402 | -53 | -7782 | 79,603 |
| 5 | Dragash | 34,241 | 354 | 695 | -341 | 52 | 149 | -97 | -438 | 33,803 |
| 6 | Istog | 39,963 | 415 | 1,417 | -1002 | 229 | 133 | 96 | -906 | 39,057 |
| 7 | Kaçanik | 33,784 | 375 | 814 | -439 | 109 | 216 | -107 | -546 | 33,238 |
| 8 | Klinë | 39,527 | 412 | 1,432 | -1020 | 216 | 247 | -31 | -1051 | 38,476 |
| 9 | Fushë Kosovë | 37,735 | 496 | 2,360 | -1864 | 824 | 177 | 647 | -1217 | 36,518 |
| 10 | Kamenicë | 33,599 | 421 | 2,601 | -2180 | 85 | 417 | -332 | -2512 | 31,087 |
| 11 | Mitrovicë e J. | 71,636 | 789 | 4,889 | -4100 | 268 | 365 | -97 | -4197 | 67,439 |
| 12 | Mitrovica e V. | 12,173 | 87 | 49 | 38 | 2 | 1 | 1 | 39 | 12,212 |
| 13 | Leposaviq | 13,515 | 78 | 42 | 36 | 3 | 9 | -6 | 30 | 13,545 |
| 14 | Lipjan | 58,373 | 635 | 3,066 | -2431 | 265 | 308 | -43 | -2474 | 55,899 |
| 15 | Novobërdë | 6,953 | 71 | 151 | -80 | 111 | 41 | 70 | -10 | 6,943 |
| 16 | Obiliq | 21,056 | 229 | 2,345 | -2116 | 183 | 187 | -4 | -2120 | 18,936 |
| 17 | Rahovec | 58,214 | 598 | 574 | 24 | 160 | 252 | -92 | -68 | 58,146 |
| 18 | Pejë | 97,776 | 975 | 2,228 | -1253 | 286 | 297 | -11 | -1264 | 96,512 |
| 19 | Podujevë | 86,836 | 922 | 4,722 | -3800 | 158 | 843 | -685 | -4485 | 82,351 |
| 20 | Prishtinë | 207,062 | 2,347 | 8,335 | -5988 | 2408 | 1253 | 1155 | -4833 | 202,229 |
| 21 | Prizren | 184,586 | 1,891 | 2,030 | -139 | 636 | 371 | 265 | 126 | 184,712 |
| 22 | Skenderaj | 51,553 | 534 | 782 | -248 | 188 | 523 | -335 | -583 | 50,970 |
| 23 | Shtime | 27,818 | 291 | 1,213 | -922 | 146 | 167 | -21 | -943 | 26,875 |
| 24 | Shtërpcë | 6,906 | 53 | 46 | 7 | 23 | 57 | -34 | -27 | 6,879 |
| 25 | Suharekë | 60,869 | 638 | 2,749 | -2111 | 249 | 263 | -14 | -2125 | 58,744 |
| 26 | Ferizaj | 107,985 | 1,158 | 9,594 | -8436 | 522 | 327 | 195 | -8241 | 99,744 |
| 27 | Viti | 47,434 | 495 | 1,680 | -1185 | 151 | 231 | -80 | -1265 | 46,169 |
| 28 | Vushtrri | 68,793 | 793 | 5,691 | -4898 | 251 | 371 | -120 | -5018 | 63,775 |
| 29 | Zubin Potok | 6,537 | 15 | 12 | 3 | 2 | 6 | -4 | -1 | 6,536 |
| 30 | Zveçan | 7,341 | 11 | 7 | 4 | 4 | 9 | -5 | -1 | 7,340 |
| 31 | Malishevë | 56,889 | 589 | 1,113 | -524 | 203 | 329 | -126 | -650 | 56,239 |
| 32 | Junik | 6,319 | 8 | 6 | 2 | 14 | 12 | 2 | 4 | 6,323 |
| 33 | Mamushë | 5,791 | 17 | 10 | 7 | 2 | 1 | 1 | 8 | 5,799 |
| 34 | Hani i Elezit | 9,759 | 63 | 114 | -51 | 45 | 41 | 4 | -47 | 9,712 |
| 35 | Graçanicë | 11,720 | 64 | 33 | 31 | 171 | 47 | 124 | 155 | 11,875 |
| 36 | Ranillug | 3,835 | 13 | 9 | 4 | 9 | 5 | 4 | 8 | 3,843 |
| 37 | Partesh | 1,738 | 8 | 5 | 3 | 6 | 4 | 2 | 5 | 1,743 |
| 38 | Kllokot | 2,709 | 12 | 9 | 3 | 31 | 17 | 14 | 17 | 2,726 |
| **Gjithsej** | | **1,804,944** | **18,862** | **74,434** | **-55,572** | **8972** | **8972** | **0** | **-55,572** | **1,749,372** |

**Tab. 3 Gjithsej, popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2015**

| Nr. | Komuna | Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2014) | Shtimi natyror (01.01-31.12.2015) | Bilanci i migrimeve (01.01-31.12.2015) | Rritja e përgjithshme për vitin 2015 | Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2015 (31 dhjetor 2015) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Deçan | 40,847 | 569 | -243 | 326 | 41,173 |
| 2 | Gjakovë | 95,576 | 1,113 | -2,146 | -1,033 | 94,543 |
| 3 | Gllogoc | 60,111 | 835 | -771 | 64 | 60,175 |
| 4 | Gjilan | 87,385 | 922 | -7,782 | -6,860 | 80,525 |
| 5 | Dragash | 34,241 | 238 | -438 | -200 | 34,041 |
| 6 | Istog | 39,963 | 547 | -906 | -359 | 39,604 |
| 7 | Kaçanik | 33,784 | 385 | -546 | -161 | 33,623 |
| 8 | Klinë | 39,527 | 732 | -1,051 | -319 | 39,208 |
| 9 | Fushë Kosovë | 37,735 | 530 | -1,217 | -687 | 37,048 |
| 10 | Kamenicë | 33,599 | 198 | -2,512 | -2,314 | 31,285 |
| 11 | Mitrovicë e J. | 71,636 | 961 | -4,197 | -3,236 | 68,400 |
| 12 | Mitrovica e V. | 12,173 | 11 | 39 | 50 | 12,223 |
| 13 | Leposaviq | 13,515 | 16 | 30 | 46 | 13,561 |
| 14 | Lipjan | 58,373 | 744 | -2,474 | -1,730 | 56,643 |
| 15 | Novobërdë | 6,953 | 20 | -10 | 10 | 6,963 |
| 16 | Obiliq | 21,056 | 229 | -2,120 | -1,891 | 19,165 |
| 17 | Rahovec | 58,214 | 762 | -68 | 694 | 58,908 |
| 18 | Pejë | 97,776 | 1,378 | -1,264 | 114 | 97,890 |
| 19 | Podujevë | 86,836 | 1,074 | -4,485 | -3,412 | 83,425 |
| 20 | Prishtinë | 207,062 | 2,492 | -4,833 | -2,341 | 204,721 |
| 21 | Prizren | 184,586 | 2,274 | 126 | 2,400 | 186,986 |
| 22 | Skenderaj | 51,553 | 776 | -583 | 193 | 51,746 |
| 23 | Shtime | 27,818 | 363 | -943 | -580 | 27,238 |
| 24 | Shtërpcë | 6,906 | 10 | -27 | -17 | 6,889 |
| 25 | Suharekë | 60,869 | 937 | -2,125 | -1,188 | 59,681 |
| 26 | Ferizaj | 107,985 | 1,430 | -8,241 | -6,811 | 101,174 |
| 27 | Viti | 47,434 | 573 | -1,265 | -692 | 46,742 |
| 28 | Vushtrri | 68,793 | 803 | -5,018 | -4,215 | 64,578 |
| 29 | Zubin Potok | 6,537 | 18 | -1 | 17 | 6,554 |
| 30 | Zveçan | 7,341 | 18 | -1 | 17 | 7,358 |
| 31 | Malishevë | 56,889 | 1,062 | -650 | 411 | 57,301 |
| 32 | Junik | 6,319 | 59 | 4 | 63 | 6,382 |
| 33 | Mamushë | 5,791 | 40 | 8 | 48 | 5,839 |
| 34 | Hani i Elezit | 9,759 | 118 | -47 | 71 | 9,830 |
| 35 | Graçanicë | 11,720 | 25 | 155 | 180 | 11,900 |
| 36 | Ranillug | 3,835 | -4 | 8 | 4 | 3,839 |
| 37 | Partesh | 1,738 | -19 | 5 | -14 | 1,724 |
| 38 | Kllokot | 2,709 | -7 | 17 | 10 | 2,719 |
| **Gjithsej** | | **1,804,944** | **22,232** | **-55,572** | **-33,340** | **1,771,604** |

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

314(496.51)"2015"(084.2)

Vlerësim : popullsia e Kosovës 2015 / [Në përgatitjen e publikimit kontribuan Bahskim Bellaqa... et al.]. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2016. - 11 f. : ilustr. ; 28 cm.

Parathënie / Isa Krasniqi: f. 4

1.Bellaqa, Bashkim

**ISBN 978-9951-22-277-8**

# Agjencia e statistikave të Kosovës

*përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** *ka këtë strukture organizative:* ***Departamentet prodhuese;*** *(Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale.* ***Departamentet mbështetëse;*** *(Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* ***Ne kuadër të*** **Agjencionit** ***vepron edhe;*** *Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomive familjare dhe banesave* si dhe ***Zyrat Rajonale;*** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministritë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID,UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistrues terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe banesave ,i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë qe t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë. Në vijim e sipër është përgatitja për Regjistrimin e Bujqësisë në Kosovë.


- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
  Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 104
  Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:**: +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** http://ask.rks-gov.net


ISBN 978-9951-22-277-8

9 789951 222778